



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.93

26 korrik

2007

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9771 datë 12.7.2007	Për ratifikimin e “Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara, për kontributet ndaj sistemit të masave mbështetëse paraprake të Kombeve të Bashkuara” 2653
Ligj nr.9772 datë 12.7.2007	Për ratifikimin e Konventës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Për kontrollin e punës në bujqësi, C 129, 1969” ... 2655
Ligj nr.9773 datë 12.7.2007	Për ratifikimin e Konventës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Për punëtorët me përgjegjësi familjare, C 156, 1981” 2662
Ligj nr.9774 datë 12.7.2007	Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis..... 2667
Ligj nr.9775 datë 12.7.2007	Për një shtesë në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar 2676
Ligj nr.9776 datë 12.7.2007	Për disa shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar..... 2676

LIGJ
Nr.9771, datë 12.7.2007

**PËR RATIFIKIMIN E “MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMBEVE TË BASHKUARA, PËR
KONTRIBUTET NDAJ SISTEMIT TË MASAVE MBËSHTETËSE PARAPRAKE
TË KOMBEVE TË BASHKUARA”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara, për kontributet ndaj sistemit të masave mbështetëse paraprake të Kombeve të Bashkuara”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5407, datë 19.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET KOMBEVE TË BASHKUARA DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË NË LIDHJE ME KONTRIBUTET NDAJ SISTEMIT TË RREGULLIMEVE TË
MBËSHTETJES SË KOMBEVE TË BASHKUARA

Nënshkruarit e Memorandumit të tanishëm, Sh.Tij.z.Besnik Mustafaj, Ministër i Punëve të Jashtme, në përfaqësim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Dr.Asha-Rose Migiro, Nënsekretar i Përgjithshëm, në përfaqësim të Kombeve të Bashkuara,

duke njohur nevojën për përshpejtimin e sigurimit të disa burimeve për Kombet e Bashkuara, me qëllim që të zbatojnë efektivisht në kohën e duhur mandatin e fushatave paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara të autorizuara nga Këshilli i Sigurimit;

duke njohur më tej se përparësitë e angazhimit të burimeve për kontributet ndaj operacioneve paqeruajtëse kontribuojnë në rritjen e fleksibilitetit dhe uljen e shpenzimeve, kanë arritur mirëkuptim për sa vijon:

I. Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi mirëkuptimi është identifikimi i burimeve, të cilat Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ka treguar se do t'i japë Kombeve të Bashkuara për përdorim në operacione paqeruajtëse, sipas kushteve të përcaktuara.

II. Përshkrimi i burimeve

1. Përshkrimi i hollësishëm i burimeve që do të sigurohen nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë përcaktohet në shtojcën ndaj këtij Memorandumi.

2. Në përgatitjen e shtojcës, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Kombet e Bashkuara kanë ndjekur udhëzimet për sigurimin e burimeve për operacionet paqeruajtëse të Kombeve të

Bashkuara.

III. Kushti i sigurimit

Vendimi përfundimtar nëse do të kalohen burimet nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë mbetet një vendim me karakter kombëtar.

IV. Hyrja në fuqi

Ky Memorandum mirëkuptimi do të hyjë në fuqi pas njoftimit nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë mbi përfundimin e procedurave të brendshme shqiptare të kërkuara për hyrjen e tij në fuqi.

V. Ndryshime

Ky Memorandum mirëkuptimi, përfshirë edhe shtojcën, mund të ndryshohet në çdo kohë nga Palët ndërmjet shkëmbimit të letrave.

VI. Përfundimi

Memorandumi i mirëkuptimit mund të përfundohet në çdo kohë nga secila Palë, duke iu nënshtruar një periudhe njoftimi jo më pak se tre muaj ndaj Palës tjetër.

Nënshkruar në Nju Jork më

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Sh.Tij.Z.Besnik Mustafaj

Ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Shqipërisë

Për Kombet e Bashkuara

Dr.Asha-Rose Migiros

Nënkretar i Përgjithshëm

SHTOJCË NDAJ MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT

NDËRMJET KOMBEVE TË BASHKUARA DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË LIDHJE ME KONTRIBUTET NDAJ SISTEMIT TË MASAVE MBËSHTETËSE PARAPRAKE TË KOMBEVE TË BASHKUARA

PËRMBLEDHJE E KONTRIBUTEVE

Numri në nivel kombëtar	Përshkrimi	Kategoria	Burimi	Përgjigja në kohë	Trupat	Vërejtjet
1.	Kompani e motorizuar këmbësorie	Personel në grup	Ushtria	60 ditë	103	Plotësisht e pajisur
2.	Oficerë personeli	Individë	Ushtria	30 ditë	5	Plotësisht të pajisur
3.	Vëzhgues ushtarakë	Individë	Ushtria	30 ditë	5	Plotësisht të pajisur
4.	Forca policore terreni për shpëtim dhe veprimtari të tjera operacionale	Individë	Policia	30 ditë	50	Plotësisht të pajisur
5.	Forca policore në terren për patrullim	Personel në grup	Policia	30 ditë	50	Plotësisht të pajisur
6.	Ekspertë të policisë për hetime krimesh	Individë/personel në grup	Policia	30 ditë	20	Plotësisht të pajisur
7.	Ekspertë trajnimi (patrullime, kontroll kufiri, luftë ndaj trafikeve të paligjshme etj.)	Individë	Policia	30 ditë	10	Plotësisht të pajisur

LIGJ
Nr.9772, datë 12.7.2007

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS
(ILO) “PËR KONTROLLIN E PUNËS NË BUJQËSI, C 129, 1969”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Për kontrollin e punës në bujqësi, C 129, 1969”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5408, datë 19.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTA
E KONTROLLIT TË PUNËS (BUJQËSI) C129, 1969

Konventa mbi Kontrollin e Punës. (Shënim: data e hyrjes në fuqi: 19.01.1972)

Konventa: C129

Vendi: Gjenevë

Sesioni i Konferencës: 53

Data e miratimit: 25/06/1969

Klasifikimi i subjektit: Kontrolli i punës

Subjekti: Administrimi dhe kontrolli i punës

Shih ratifikimet e kësaj Konvente.

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, organizuar në San Francisko nga organi drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës, në sesionin e saj të tridhjetetretë, më 4 qershor 1969; dhe

duke vërejtur kushtet e konventave ekzistuese ndërkombëtare të punës mbi kontrollin e punës, si p.sh. Konventa e Kontrollit të Punës e vitit 1947, e cila zbatohet në industri dhe tregti dhe Konventa e Plantacioneve e vitit 1958, e cila mbulon një kategori të kufizuar të sipërmarrjeve bujqësore; dhe

duke marrë parasysh faktin se standardet ndërkombëtare të parashikuara për kontrollin bujqësor në përgjithësi janë të kënaqshme; dhe

pasi është vendosur mbi miratimin e disa propozimeve në lidhje me kontrollin e punës në bujqësi i cili përbën pikën e katërt të agjendës së sesionit; dhe

pasi është përcaktuar që këto propozime të marrin formën e një konvente ndërkombëtare, miraton më njëzet e pesë qershor të vitit njëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë Konventën e mëposhtme, e cila mund të referohet si Konventa e Kontrollit të Punës (Bujqësi), 1969.

Neni 1

1. Në këtë Konventë termi “sipërmarrje bujqësore” nënkupton një sipërmarrje ose pjesë të sipërmarrjes, që ka të bëjë me kultivimin, administrimin e kafshëve, përfshirë këtu prodhime dhe kujdesin për gjënë e gjallë, pylltarinë, kopshtarinë, përpunimin fillestar të prodhimeve bujqësore nga operatori i sipërmarrjes ose çdo formë aktiviteti tjetër bujqësor.

2. Pas konsultimit me shumicën e organizatave përfaqësuese të punëdhënësve dhe punëmarrësve të interesuar, atje ku ato ekzistojnë, autoriteti kompetent do të përcaktojë sipas nevojës vijën ndarëse të bujqësisë nga industria dhe tregtia, në mënyrë që të mos përjashtojë ndonjë sipërmarrje bujqësore nga sistemi kombëtar i kontrollit të punës.

3. Në çdo rast, kur dyshohet nëse kjo Konventë zbatohet për një sipërmarrje ose pjesë të një sipërmarrjeje, çështja zgjidhet nga autoriteti kompetent.

Neni 2

Në këtë Konventë termi “dispozita ligjore” përfshin, përveç ligjeve dhe rregulloreve, vendimet e arbitrazhit dhe marrëveshjet e përbashkëta mbi të cilat vepron forca e ligjit dhe që janë të zbatueshme nga inspektorët e punës.

Neni 3

Çdo anëtar i Organizatës Ndërkombëtare të Punës, për të cilët kjo Konventë ka hyrë në fuqi, do të sigurojë një sistem kontrolli të punës në bujqësi.

Neni 4

Sistemi i kontrollit të punës në bujqësi zbatohet kundrejt sipërmarrjeve në të cilat angazhohen punëmarrësit ose shegertët, pavarësisht nga shpërblimi, lloji, forma ose kohëzgjatja e kontratës.

Neni 5

1. Çdo anëtar ratifikues i kësaj Konvente mundet, në deklaratën që shoqëron ratifikimin, të marrë përsipër të mbulojë me anë të kontrollit të punës në bujqësi një ose më shumë nga kategoritë e mëposhtme të punëtorëve të angazhuar në sipërmarrjet bujqësore:

a) qiramarrësit, të cilët nuk përdorin ndihmë të jashtme, punëtorë që marrin gjysmën e prodhimit dhe kategori të ngjashme të punëtorëve bujqësorë;

b) personat që marrin pjesë në një sipërmarrje ekonomike kolektive, si p.sh. anëtarët e një kooperative;

c) anëtarët e familjes së operuesit të sipërmarrjes të përcaktuar nga legjislacioni dhe rregulloret kombëtare.

2. Më pas, çdo anëtar, i cili ka ratifikuar këtë Konventë, mund t'i komunikojë Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës një deklaratë, me anë të së cilës të marrë përsipër të mbulojë një ose më shumë nga kategoritë e personave të lartpërmendur në paragrafin paraprijës, të cilët nuk janë mbuluar nga një deklaratë e mëparshme.

3. Çdo anëtar i cili ka ratifikuar këtë Konventë do të tregojë në raportet e tij sipas nenit 22 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës se në çfarë mase kanë hyrë në fuqi ose propozohet të hyjnë në fuqi dispozitat e Konventës, për sa i përket kategorive të personave të referuar në paragrafin 1 të këtij neni, të pambuluar nga një deklaratë e mëparshme.

Neni 6

1. Funksionet e sistemit të kontrollit të punës në bujqësi –

a) të sigurojë zbatimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me kushtet e punës dhe mbrojtjen e

punëtorëve gjatë punës, si p.sh. dispozitat mbi orët, pagën, pushimet javore dhe vjetore, sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien, punësimin e grave, fëmijëve dhe të rinjve, dhe çështje të ngjashme për sa kohë që këto dispozita të jenë të zbatueshme nga inspektorët e punës.

b) t'u sigurojë punëdhënësve dhe punëmarrësve informacion teknik mbi masat më efektive të zbatimit të dispozitave ligjore;

c) t'i parashtrijë autoritetit kompetent defektet dhe abuzimet e pambuluara specifikisht nga dispozitat ligjore ekzistuese dhe t'i paraqesë atij propozime mbi përmirësimin e legjislacionit dhe rregullave.

2. Legjislacioni dhe rregulloret kombëtare mund t'u japin inspektorëve të punës në bujqësi funksione këshilluese ose zbatuese në lidhje me dispozitat ligjore të kushteve të jetesës së punëtorëve dhe familjeve të tyre.

3. Çdo detyrë tjetër që mund t'u besohet inspektorëve të punës në bujqësi nuk duhet të jetë e tillë që të bjerë ndesh me realizimin efektiv të detyrave të tyre parësore ose të cenojë në çfarëdo mënyre autoritetin dhe paañsinë që iu nevojiten inspektorëve në marrëdhëniet e tyre me punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Neni 7

1. Për aq sa është e pajtueshme me praktikën administrative të Anëtarit, kontrolli i punës në bujqësi vendoset nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e një organi qendror.

Në rast të një shteti federal, termi "organ qendror" mund të nënkuptojë një organ në nivel federal ose një në nivel nën ndarje federale.

K kontrolli i punës në bujqësi realizohet p.sh.:

a) nga një departament i vetëm kontrolli të punës, përgjegjës për të gjithë sektorët e aktivitetit ekonomik;

b) nga një departament i vetëm kontrolli të punës, i cili cakton degën institucionale funksionale nëpërmjet trajnimit të duhur të inspektorëve të caktuar për të ushtruar funksionet në bujqësi;

c) nga një departament i vetëm kontrolli të punës, i cili cakton degën institucionale të brendshme duke krijuar një shërbim teknik të kualifikuar, nëpunësit e të cilit do të ushtrjnë funksionet e tyre në bujqësi; ose

d) nga një shërbim kontrolli bujqësor të specializuar, aktiviteti i të cilit mbikëqyret nga një organ qendror të cilit i janë atribuar të drejta të barabarta për sa i përket kontrollit të punës në fusha të tjera, si p.sh. industria, transporti dhe tregtia.

Neni 8

1. Stafit i kontrollit të punës në bujqësi përbëhet nga nëpunës publikë, statusi dhe kushtet e shërbimit të të cilëve janë të tilla që sigurojnë punësim të qëndrueshëm, pavarësi nga ndryshimet qeverisëse dhe ndikimet e jashtme të gabuara.

2. Për sa kohë që ekziston pajtueshmëria me legjislacionin, rregulloren dhe praktikën kombëtare, anëtarët mund të përfshijnë në sistemin e tyre të kontrollit të punës në bujqësi nëpunës ose përfaqësues të organizatave profesionale, aktivitetet e të cilave plotësojnë ato të stafit të kontrollit publik; personave në fjalë do t'u sigurohet qëndrueshmëria e pozicionit dhe pavarësia nga ndikimet e jashtme të gabuara.

Neni 9

1. Në varësi të kushteve për rekrutim në shërbimin publik të cilat mund të jenë parashikuar nga legjislacioni dhe rregullat kombëtare, inspektorët e punës në bujqësi rekrutohen mbi bazën e vetme të kualifikimeve për realizimin e detyrave.

2. Mjetet e vërtetimit të kualifikimeve të tilla përcaktohen nga autoriteti kompetent.

3. Inspektorët e punës në bujqësi do të jenë të kualifikuar në mënyrë të mjaftueshme për realizimin e detyrave të tyre dhe do të ndërmerren masa për kualifikimin e mëtejshëm të tyre gjatë periudhës së punësimit.

Neni 10

Si burrat, ashtu edhe gratë janë të pranueshëm për t'u emëruar në stafin e kontrollit të punës në bujqësi, sipas nevojës, inspektorëve burra e gra iu ngarkohen detyra të veçanta.

Neni 11

Çdo anëtar merr masat e nevojshme për të siguruar që ekspertët dhe specialistët me kualifikimet e duhura teknike, të cilët mund të ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve që kërkojnë njohuri teknike, angazhohen në detyrën e kontrollit të punës në bujqësi, sipas mënyrës që çmohet më e përshtatshme në kushtet kombëtare.

Neni 12

1. Autoriteti kompetent ndërmerr masat e duhura për të nxitur bashkëpunimin efektiv ndërmjet shërbimeve të kontrollit në bujqësi dhe shërbimeve qeveritare e publike ose institucioneve të miratuara të cilat angazhohen në detyra të njëjta.

2. Sipas nevojës, autoriteti kompetent mund t'i besojë funksione të veçanta kontrolli ndihmës në nivel lokal apo rajonal shërbimeve të duhura qeveritare e institucioneve publike ose t'i shoqërojë këto shërbime ose institucione me ushtrimin e funksioneve në fjalë, me kusht që kjo të mos cenojë zbatimin e parimeve të kësaj Konvente.

Neni 13

Autoriteti kompetent ndërmerr masat e duhura për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet nëpunësve të inspektoratit të punës në bujqësi dhe punëdhënësve e punëmarrësve, ose organizatave të tyre, atje ku ekzistojnë.

Neni 14

Do të merren masa për të siguruar se numri i inspektorëve në bujqësi është i mjaftueshëm për të siguruar realizimin efektiv të detyrave të inspektoratit dhe përcaktohen në lidhje me--

- a) rëndësinë e detyrave të cilat inspektorët duhet të kryejnë, në veçanti; --
- b) numrin, natyrën, volumnin dhe vendndodhjen e sipërmarrjeve bujqësore të planifikuara për inspektim;
 - i) numrin dhe shtresat e personave të angazhuar në sipërmarrje të tilla; dhe
 - ii) numrin dhe kompleksitetin e dispozitave ligjore që duhet të zbatohen;
- b) mjetet materiale të vëna në dispozicion të inspektorëve; dhe
- c) kushtet praktike, në bazë të të cilave do kryhen vizitat e kontrollit, në mënyrë që të jenë efektive.

Neni 15

1. Autoriteti kompetent merr masat e nevojshme për të pajisur inspektorët e punës në bujqësi me:

- a) zyra lokale të vendosura në vende ku të merret parasysh pozicioni gjeografik i sipërmarrjeve bujqësore dhe mjetet e komunikimit, të pajisura në mënyrën e duhur në përputhje me kërkesat e shërbimit, dhe në mënyrë që personat përkatës të kenë një shkallë sa më të lartë aksesit ndaj tyre;
- b) lehtësira të nevojshme transporti për kryerjen e detyrave të tyre në rastet kur shërbime publike të përshtatshme nuk ekzistojnë.

2. Autoriteti kompetent merr masat e nevojshme për të rimbursuar inspektorët e punës në bujqësi me shpenzimet e rastit dhe të udhëtimit, të cilat mund të jenë të nevojshme për kryerjen e detyrave.

Neni 16

1. Inspektorët e punës në bujqësi të pajisur me kredencialet e duhura autorizohen:

a) të hyjnë lirshëm dhe pa njoftim paraprak në çdo orë të ditës e natës në çdo vend pune të mundshëm për inspektim;

b) të hyjnë ditën në çdo ambient, për të cilin kanë arsye të besojnë se duhet t'i nënshtrohen inspektimit;

c) të kryejnë kontrolle, shqyrtime ose hetime, të cilat mund t'i çmojnë të nevojshme për t'u siguruar se dispozitat ligjore zbatohen rigorozisht dhe në veçanti:

i) të intervistojnë, vetëm apo në praninë e dëshmitarëve, punëdhënësin, stafin e sipërmarrjes ose një person tjetër në sipërmarrje mbi çdo çështje që ka të bëjë me zbatimin e dispozitave ligjore;

ii) të kërkojë, sipas mënyrës së parashikuar në legjislacionin dhe rregulloren kombëtare, nxjerrjen e librave, regjistrave ose dokumenteve, mbajtja e të cilave parashikohet nga legjislacioni dhe rregullorja kombëtare, që kanë të bëjnë me kushtet e jetesës dhe punës, për të vërtetuar se ato janë në pajtim me dispozitat ligjore, dhe të kopjojë dokumente ose pjesë të shkëputura nga to;

iii) të marrë apo zhvendosë për qëllime kontrolli mostra prodhimesh, materialesh dhe substancash që përdoren apo trajtohen, me kusht njoftimin e punëdhënësit ose përfaqësuesit të tij mbi prodhimet, materialet, apo substancat e marra ose të zhvendosura për këto qëllime.

2. Në zbatim të nënparagrafëve (a) dhe (b) të paragrafit 1 të këtij neni, inspektorët e punës nuk hyjnë në shtëpinë private të operuesit të sipërmarrjes, përveç rasteve me pëlqimin e operuesit ose me një autorizim të veçantë të lëshuar nga autoriteti kompetent.

3. Në rastin e një kontrolli, inspektorët njoftojnë punëdhënësin ose përfaqësuesin e tij, dhe punëtorët ose përfaqësuesit e tyre mbi praninë e tyre, nëse një njoftim i tillë nuk cenon kryerjen e detyrave të tyre.

Neni 17

Shërbimet e kontrollit të punës në bujqësi organizohen, në rastet dhe në mënyrën e përcaktuar nga autoriteti kompetent, për kontrollin me efekt parandalues të një fabrike të re, materialeve ose substancave të reja dhe metodave të reja përdorimit apo përpunimit të produkteve të cilat duken se paraqesin rrezik për shëndetin dhe sigurinë.

Neni 18

1. Inspektorët e punës në bujqësi autorizohen të ndërmarrin hapa me synim ndreqjen e defekteve të vërejtura në fabrikë, në metodat e organizimit apo punësimit në sipërmarrjet bujqësore, përfshirë përdorimin e materialeve apo substancave të rrezikshme, për të cilat ata mund të kenë arsye të mjaftueshme të besojnë se përbëjnë rrezik për shëndetin apo sigurinë.

2. Në mënyrë që t'u jepet mundësia të ndërmarrin këto hapa, inspektorët autorizohen, duke iu nënshtuar të drejtës për apelim pranë një autoriteti ligjor apo administrativ të parashtruar me ligj, të kryejnë apo të kenë kryer urdhra me anë të të cilëve kërkohen:

a) ndryshime në instalime, fabrikë, ambiente, vegla pune, pajisje apo makineri, që duhet të realizohen brenda një kohe të përcaktuar, e nevojshme për të siguruar pajtueshmëri me dispozitat ligjore në lidhje me shëndetin ose sigurinë; ose

b) masa me fuqi veprimi të menjëhershëm, që mund të shkojnë deri në pezullimin e punës, në rast rreziku të pashmangshëm ndaj shëndetit ose sigurisë.

3. Kur procedurat e përshkruara në paragrafin 2 nuk përputhen me praktikat administrative apo gjyqësore të anëtarit, inspektorëve u lind e drejta t'i drejtohen autoritetit kompetent për nxjerrjen e urdhrave ose për ndërmarrjen e masave me fuqi vepruese të menjëhershme.

4. Defektet e vërejtura nga inspektori gjatë vizitës së sipërmarrjes dhe urdhrat që ai nxjerr apo ka nxjerrë në zbatim të paragrafit 2 ose për të cilat ai synon t'i zbatojë në bazë të paragrafit 3, duhet t'i bëhen menjëherë të njohura punëdhënësit dhe përfaqësuesve të punëtorëve.

Neni 19

1. Inspektorati i punës në bujqësi njoftohet mbi aksidentet profesionale dhe rastet e sëmundjeve profesionale të hasura në sektorin bujqësor, në masën dhe mënyrën e parashikuar nga ligjet dhe rregulloret kombëtare.

2. Inspektorët njoftohen e shoqërohen në shkallën më të lartë të mundshme për çdo hetim në terren mbi shkaqet e aksidenteve më të rënda profesionale apo sëmundjeve profesionale, veçanërisht të atyre rasteve që cenojnë një numër punëtorësh ose që kanë pasoja fatale.

Neni 20

Kushtëzuar nga përjashtimet e mundshme sipas ligjeve ose rregulloreve kombëtare, inspektorët e punës në bujqësi:

- a) ndalohen të kenë interes të drejtpërdrejtë ose jo mbi sipërmarrjet që kanë nën kontroll;
- b) detyrohen të ndëshkohen me gjoba përkatëse ose masa disiplinore për të mos zbuluar, edhe pas largimit nga detyra, sekrete prodhimi, biznesi ose procese pune që mund të hasen prej tyre gjatë kryerjes së detyrës; dhe
- c) trajtojnë si tepër konfidenciale burimin e çdo ankimi që çon në zbulimin e një defekti, një rreziku në proceset e punës ose një shkelje të dispozitave ligjore dhe nuk i bëjnë aludime punëdhënësit ose përfaqësuesit të tij se kontrolli ishte pasojë e marrjes së një ankimi të tillë.

Neni 21

Sipërmarrjet bujqësore kontrollohen aq shpesh dhe me aq imtësi sa është e nevojshme për të siguruar zbatimin efektiv të dispozitave ligjore përkatëse.

Neni 22

1. Ndaj personave që shkelin apo neglizhojnë të zbatojnë dispozitat ligjore të zbatueshme nga inspektorët e punës në bujqësi, merren procedime të menjëhershme ligjore ose administrative pa paralajmërim paraprak; me kusht që mund të bëhen përjashtime nga ligjet dhe rregulloret kombëtare në lidhje me rastet në të cilat pritet të jepet njoftimi paraprak për marrjen e masave rregullatore apo parandaluese.

2. Inspektorëve të punës u lihet liri veprimi për të paralajmëruar dhe këshilluar në vend që të rekomandojnë apo fillojnë procedime.

Neni 23

Në rast se inspektorët e punës në bujqësi nuk janë të autorizuar të fillojnë procedime, ata autorizohen të përcjellin raportet e shkeljeve të dispozitave ligjore drejtpërsëdrejti te një autoritet kompetent për të filluar këto procedime.

Neni 24

Ndëshkime të mjaftueshme për shkelje të dispozitave ligjore të zbatueshme nga inspektorët në bujqësi dhe për pengim të inspektorëve të punës në kryerjen e detyrave të tyre parashikohen në ligjet dhe rregulloret e vendeve përkatëse, të cilat duhet të zbatohen efektivisht.

Neni 25

1. Inspektorëve të punës apo zyrës së kontrollit lokal, sipas rastit, u kërkohet të paraqesin pranë autoritetit të kontrollit qendror raporte periodike mbi rezultatet e veprimtarisë së tyre bujqësore.

2. Këto raporte përpilohen në mënyrë të tillë dhe trajtojnë tema të tilla që herë pas here këshillohen nga autoriteti i kontrollit qendror; raportet paraqiten të paktën aq shpesh sa parashikohet nga autoriteti përkatës dhe në çdo rast jo më rrallë se një herë në vit.

Neni 26

1. Autoriteti i kontrollit qendror publikon një raport vjetor mbi punën e shërbimeve të kontrollit në bujqësi si raport më vete ose si pjesë e raportit të përgjithshëm vjetor.

2. Raporte të tilla vjetore publikohen brenda një kohe të arsyeshme nga data e mbarimit të vitit përkatës dhe në çdo rast brenda dymbëdhjetë muajve.

3. Kopje të raporteve vjetore i dorëzohen Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës brenda tre muajve nga data e publikimit.

Neni 27

Raporti vjetor i publikuar nga autoriteti i kontrollit qendror trajton në veçanti temat e mëposhtme, aq sa mund të jenë nën kontrollin e autoritetit në fjalë:

- a) ligjet dhe rregulloret që kanë të bëjnë me kontrollin e punës në bujqësi;
- b) stafin e shërbimit të kontrollit të punës në bujqësi;
- c) të dhëna të sipërmarrjeve bujqësore të detyrueshme për inspektim, si dhe numrin e personave të punësuar në to;
- d) të dhëna të vizitave të kontrollit;
- e) të dhëna të shkeljeve dhe ndëshkimeve të marra;
- f) të dhëna të aksidenteve profesionale, përfshirë shkaqet;
- g) të dhëna të sëmundjeve profesionale, përfshirë shkaqet.

Neni 28

Ratifikimi zyrtar i kësaj Konvente i komunikohet Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim.

Neni 29

1. Kjo Konventë është e detyrueshme vetëm mbi ata anëtarë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ratifikimet e të cilëve janë regjistruar pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

2. Konventa hyn në fuqi dymbëdhjetë muaj nga data në të cilën dy anëtarë regjistrohen pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

3. Pas kësaj, Konventa hyn në fuqi për çdo anëtar, dymbëdhjetë muaj nga data e regjistrimit të ratifikimit.

Neni 30

1. Pasi të kenë kaluar dhjetë vjet nga data në të cilën Konventa ka hyrë në fuqi, një anëtar i cili ka ratifikuar këtë Konventë mund ta shpallë atë të pavlefshme me anë të një akti komunikuar Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim. Kjo zgjidhje e Konventës nuk do të ketë fuqi deri në një vit pas datës së regjistrimit.

2. Çdo anëtar i cili ka ratifikuar këtë Konventë dhe që brenda vitit që pason mbarimin e periudhës dhjetëvjeçare të përmendur në paragrafin paraprijës, nuk ka ushtruar të drejtën për zgjidhjen e marrëveshjes të parashikuar në këtë nen, ka detyrim ligjor për një periudhë tjetër dhjetëvjeçare dhe pas kësaj, mund ta shpallë këtë Konventë të pavlefshme pas mbarimit të çdo periudhe dhjetëvjeçare sipas kushteve të parashikuara në këtë nen.

Neni 31

1. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës njofton të gjithë anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës në lidhje me regjistrimet e të gjitha ratifikimeve, deklarimeve dhe zgjidhjeve të marrëveshjes të komunikuar atij nga ana e anëtarëve të Organizatës.

2. Në njoftimin e anëtarëve të Organizatës mbi regjistrimin e ratifikimit të dytë, Drejtori i Përgjithshëm u tërheq vëmendjen anëtarëve të Organizatës në lidhje me datën në të cilën Konventa hyn në fuqi.

Neni 32

Në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës Ndërkombëtare të Punës i komunikon Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për regjistrim detajet e çdo ratifikimi, deklarimi, dhe akti zgjidhjeje të regjistruar prej tij në përputhje me dispozitat e neneve paraprijës.

Neni 33

Kur organi drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës e çmon të arsyeshme, ai i paraqet Konferencës së Përgjithshme një raport mbi ecurinë e kësaj Konvente dhe shqyrton preferencën e vendosjes në agjendën e konferencës të çështjes së rishikimit të Konventës, pjesërisht ose në tërësi.

Neni 34

1. Konferenca mund të miratojë një konventë të re që rishikon këtë Konventë pjesërisht ose në tërësi, nëse konventa e re nuk parashikon ndryshe, atëherë:

a) ratifikimi nga një anëtar i Konventës së re të rishikuar nënkupton *ipso jure* zgjidhjen e menjëhershme të kësaj Konvente, pavarësisht nga dispozitat e nenit 30 të mësipërm, në momentin kur konventa e re e rishikuar hyn në fuqi;

b) nga data kur konventa e re e rishikuar hyn në fuqi, kjo Konventë nuk mund të ratifikohet më nga anëtarët.

2. Kjo Konventë mbetet në çdo rast në fuqi në formën dhe përmbajtjen e saj aktuale për ata anëtarë të cilët e kanë ratifikuar atë, por nuk kanë ratifikuar Konventën e rishikuar.

Neni 35

Versionet në gjuhën angleze dhe frënge të tekstit të kësaj Konvente janë njëjloj të barazvlefshme.

LIGJ

Nr.9773, datë 12.7.2007

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS (ILO) “PËR PUNËTORËT ME PËRGJEGJËSI FAMILJARE, C 156, 1981”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Për punëtorët me përgjegjësi familjare, C 156, 1981”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5409, datë 19.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTA
E PUNËTORËVE ME PËRGJEGJËSI FAMILJARE C 156, 1981

Konventë mbi Mundësitë dhe Trajtimin e Barabartë për Punëtorët Burra e Gra: Punëtorët me Përgjegjësi Familjare (Shënim: data e hyrjes në fuqi: 11.8.1983)

Konventa: C156

Vendi: Gjenevë

Sesioni i Konferencës: 67

Data e aprovimit: 23.6.1981

Klasifikimi i subjektit: Barazia e shanseve dhe e trajtimit

Klasifikimi i subjektit: Gratë

Shih ratifikimet e kësaj Konvente.

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, organizuar në Gjenevë nga organi drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës në sesionin e saj të gjashtëdhjeteshtatë më 3 qershor 1981; dhe

duke i kushtuar vëmendje Deklaratës së Filadelfias mbi Synimet dhe Qëllimet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, e cila pranon se “të gjithë njerëzit, pavarësisht nga raca, besimi ose gjinia, gëzojnë të drejtën për të plotësuar mirëqenien materiale dhe zhvillimin shpirtëror në kushtet e lirisë dhe dinjitetit, të sigurisë ekonomike dhe mundësive të barabarta”; dhe

duke vërejtur kushtet e Deklaratës mbi Barazinë e Shanseve dhe të Trajtimit të Punëtorëve Gra dhe të rezolutës mbi planin e veprimit me synim nxitjen e barazisë së shanseve dhe trajtimit për punëtorët gra, të miratuar nga Konferenca Ndërkombëtare e Punës e vitit 1975; dhe

duke vërejtur se dispozitat e konventave dhe rekomandimeve ndërkombëtare të punës kanë pasur për qëllim sigurimin e barazisë së shanseve dhe trajtimit për punëtorët burra e gra, kryesisht Konventa dhe Udhëzimi për Shpërblime të Barabarta e vitit 1951, Konventa dhe Udhëzimi mbi Diskriminimin (Punësimin dhe profesionin) e vitit 1958 dhe pjesën e VIII-të të Udhëzimit për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore të vitit 1975; dhe

duke risjellë në mendje se Konventa mbi Diskriminimin (Punësimin dhe Profesionin) e vitit 1958 nuk mbulon qartë dallimet e kryera mbi bazat e përgjegjësive familjare dhe duke pasur parasysh se nevojiten standardet plotësuese në këtë aspekt; dhe

duke vërejtur se kushtet e rekomandimit mbi punësimin (grave me përgjegjësi familjare) të vitit 1965, dhe duke pasur parasysh se ndryshimet që kanë ndodhur që nga koha e miratimit të saj; dhe

duke vërejtur se instrumentet mbi barazinë e shanseve dhe trajtimit të burrave dhe grave janë miratuar gjithashtu nga Kombet e Bashkuara dhe agjenci të tjera të specializuara, dhe duke risjellë në mendje, në veçanti, paragrafin e katërbëdhjetë të parathënies së Konventës të Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave të vitit 1979, me qëllim që Palët e shteteve “të ndërjegjësohen se nevojitet një ndryshim mbi rolin tradicional të burrave dhe grave në shoqëri dhe familjeve për të arritur barazi të plotë ndërmjet burrave dhe grave”; dhe

duke pranuar se problemet e punëtorëve me përgjegjësi familjare janë aspekte të çështjeve më të gjera në lidhje me familjen dhe shoqërinë të cilat duhet të merren parasysh në politikat shtetërore; dhe

duke pranuar nevojën për të krijuar barazi, shanse dhe trajtim efektiv si midis punëtorëve burra e gra dhe përgjegjësive familjare, ashtu edhe ndërmjet këtyre punonjësve dhe punonjësve të tjerë; dhe

duke gjykuar se shumë nga problemet me të cilat punonjësit përballen, përkeqësohen në rastin e punonjësve me përgjegjësi familjare dhe duke pranuar nevojën për të përmirësuar kushtet e atyre personave me përgjegjësi familjare, me anë të masave që i përshtaten nevojave të tyre të veçanta dhe masave që synojnë përmirësimin e kushteve të punëtorëve në përgjithësi; dhe

pasi është vendosur mbi miratimin e disa propozimeve në lidhje me shanse dhe trajtim të barabartë për punonjësit burra e gra: punonjësit me përgjegjësi familjare, e cila përbën pikën e pestë në rendin e ditës të sesionit; dhe

pasi është përcaktuar që këto propozime të marrin formën e një konvente ndërkombëtare, miraton më njëzetë e tre qershor, njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një Konventën e mëposhtme, e cila mund të referohet si Konventa e Punëtorëve me Përgjegjësi Familjare, 1981.

Neni 1

1. Kjo Konventë zbatohet për punëtorët, burra e gra, me përgjegjësi kundrejt fëmijëve të varur prej tyre, ku përgjegjësisira të tilla kufizojnë mundësitë e tyre për t'u përgatitur, filluar, marrë pjesë ose përparuar në aktivitetin ekonomik.

2. Dispozitat e kësaj Konvente zbatohen gjithashtu për punëtorët, burra dhe gra, me përgjegjësi kundrejt anëtarëve të tjerë më të afërt të familjeve të tyre, të cilët kanë nevojë të dukshme për kujdesin dhe mbështetjen e tyre, ku përgjegjësi të tilla kufizojnë mundësitë e tyre për t'u përgatitur, filluar, marrë pjesë ose përparuar në aktivitetin ekonomik.

3. Për qëllime të kësaj Konvente, termat “fëmijë në varësi” dhe “anëtar tjetër më i afërt i familjes të cilët kanë nevojë ose mbështetje të dukshme”, nënkuptojnë persona të përcaktuar si të tillë në çdo vend me mënyrat e përmendura në nenin 9 të kësaj Konvente.

4. Punëtorët që trajtohen në bazë të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, këtu e më poshtë referohen si “punëtorë me përgjegjësi familjare”.

Neni 2

Kjo Konventë zbatohet në të gjitha degët e aktivitetit ekonomik dhe për të gjitha kategoritë e punëtorëve.

Neni 3

1. Me synim krijimin e barazisë efektive të mundësive dhe trajtimit të punëtorëve, burra dhe gra, çdo anëtar e vë objektiv të politikës së vendit të tij t'u mundësojë personave me përgjegjësi familjare, të cilët janë të angazhuar ose dëshirojnë të angazhohen në punë, ushtrimin e së drejtës për të realizuar një gjë të tillë pa u diskriminuar dhe, sipas mundësive, pa konflikt ndërmjet profesionit dhe përgjegjësive familjare.

2. Për qëllime të paragrafit 1 të këtij neni, termi “diskriminim” nënkupton diskriminim në punë dhe profesion, siç përcaktohet nga nenet 1 dhe 5 të Konventës së Diskriminimit (Punësimi dhe Profesionit) të vitit 1958.

Neni 4

Me synim krijimin e barazisë efektive të mundësive dhe trajtimit për punëtorët, burra e gra, ndërmerren të gjitha masat që pajtohen me kushtet dhe mundësitë e vendit:

a) për t'u mundësuar punëtorëve me përgjegjësi familjare të ushtrojnë të drejtën e tyre për të zgjedhur punësimin me vullnetin e tyre të lirë;

b) për të marrë në konsideratë nevojat e tyre që kanë të bëjnë me kushtet e punësimit dhe sigurimet shoqërore.

Neni 5

Do të ndërmerren më tej të gjitha masat që pajtohen me kushtet dhe mundësitë e vendit:

a) duke marrë në konsideratë nevojat e punëtorëve me përgjegjësi familjare në planifikimin komunitar; dhe

b) për të zhvilluar dhe nxitur shërbimet komunitare, publike ose private, si p.sh. kujdesi për fëmijët dhe shërbimi, e lehtësirat familjare.

Neni 6

Autoritetet dhe organet kompetente në çdo vend do të marrin masat e duhura për të nxitur dhënien e informacionit dhe edukimin, me qëllim zgjerimin e të kuptuarit nga të gjithë të parimit të barazisë së shanseve dhe trajtimit për punëtorët burra e gra dhe të problemeve të punëtorëve me përgjegjësi familjare, si dhe krijimit të një klime të favorshme për të kapërcyer këto probleme.

Neni 7

Do të ndërmerren të gjitha masat që pajtohem me kushtet dhe mundësitë e vendit, përfshirë masat në fushën e orientimit dhe kualifikimit profesional, për t'u dhënë mundësinë punëtorëve me përgjegjësi familjare të integrohen dhe të mbeten të integruar në fuqinë punëtore, si dhe të riaktivizohen pas një mungese si rrjedhojë e këtyre përgjegjësi.

Neni 8

Si të tilla, përgjegjësitë familjare nuk do të përbëjnë një arsye të vlefshme për mbarimin e punësimit.

Neni 9

Dispozitat e kësaj Konvente mund të zbatohen nga ligjet ose rregulloret, marrëveshjet kolektive, rregulloret e punës, vendimet gjyqësore, vendimet e gjykatës apo një kombinim të këtyre metodave, ose të çdo mënyre të përshtatshme me praktikën e vendit, duke marrë parasysh kushtet e vendit.

Neni 10

1. Nëse është e nevojshme, dispozitat e kësaj Konvente zbatohen me faza, duke marrë parasysh kushtet e vendit; me kusht që këto masa zbatuese të aplikohen në çdo rast kundrejt të gjithë punëtorëve të referuar në nenin 1 paragrafi 1.

2. Çdo anëtar i cili ratifikon këtë Konventë, do të tregojë në raportin e parë mbi zbatimin e Konventës të parashtruar sipas nenit 22 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës se në çfarë aspekti, nëse ka, ai mendon të shfrytëzojë mundësitë e dhëna nga paragrafi 1 i këtij neni dhe do të deklarojë në raportet vijuese nivelin e zbatuar ose nivelin e propozuar për zbatimin e Konventës në atë pikëpamje.

Neni 11

Organizatata e punëdhënësve dhe punëtorëve gëzojnë të drejtën të marrin pjesë në një mënyrë të përshtatshme me praktikën dhe kushtet e vendit në përcaktimin dhe zbatimin e masave për hyrjen në fuqi të dispozitave të kësaj Konvente.

Neni 12

Ratifikimi zyrtar i kësaj Konvente i komunikohet Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim.

Neni 13

1. Kjo Konventë është e detyrueshme vetëm mbi ata anëtarë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ratifikimet e të cilëve janë regjistruar pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

2. Konventa hyn në fuqi dymbëdhjetë muaj nga data në të cilën dy anëtarë regjistrohen pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

3. Pas kësaj, Konventa hyn në fuqi, për çdo anëtar, dymbëdhjetë muaj nga data e regjistrimit të ratifikimit.

Neni 14

1. Pasi të kenë kaluar dhjetë vjet nga data në të cilën Konventa ka hyrë në fuqi, një anëtar i cili ka ratifikuar këtë Konventë, mund ta shpallë atë të pavlefshme me anë të një akti komunikuar Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim. Kjo zgjidhje e Konventës nuk do të ketë fuqi deri në një vit pas datës së regjistrimit.

2. Çdo anëtar, i cili ka ratifikuar këtë Konventë dhe që brenda vitit që pason mbarimin e periudhës dhjetëvjeçare të përmendur në paragrafin paraprirës, nuk ka ushtruar të drejtën për zgjidhjen e marrëveshjes të parashikuar në këtë nen, ka detyrim ligjor për një periudhë tjetër dhjetëvjeçare dhe pas kësaj mund ta shpallë këtë Konventë të pavlefshme pas mbarimit të çdo periudhe dhjetëvjeçare, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen.

Neni 15

1. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës njofton të gjithë anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës në lidhje me regjistrimet e të gjitha ratifikimeve, deklarimeve dhe zgjidhjeve të marrëveshjes të komunikuar atij nga ana e anëtarëve të Organizatës.

2. Në njoftimin e anëtarëve të Organizatës mbi regjistrimin e ratifikimit të dytë, Drejtori i Përgjithshëm u tërheq vëmendjen anëtarëve të Organizatës në lidhje me datën në të cilën Konventa hyn në fuqi.

Neni 16

Në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës Ndërkombëtare të Punës i komunikon Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për regjistrim detajet e çdo ratifikimi, deklarimi dhe akti zgjidhjeje të regjistruar prej tij në përputhje me dispozitat e neneve paraprijës.

Neni 17

Kur organi drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës e çmon të arsyeshme, ai i paraqet Konferencës së Përgjithshme një raport mbi ecurinë e kësaj Konvente dhe shqyrton preferencën e vendosjes në agjendën e konferencës të çështjes së rishikimit të Konventës, pjesërisht ose në tërësi.

Neni 18

1. Konferenca mund të miratojë një konventë të re, që rishikon këtë Konventë, pjesërisht ose në tërësi, nëse konventa e re nuk parashikon ndryshe, atëherë:

a) ratifikimi nga një anëtar i konventës së re të rishikuar nënkupton *ipso jure* zgjidhjen e menjëhershme të kësaj Konvente, pavarësisht nga dispozitat e nenit 14 të mësipërm, në momentin kur Konventa e re e rishikuar hyn në fuqi;

b) nga data kur konventa e re e rishikuar hyn në fuqi, kjo Konventë nuk mund të ratifikohet më nga anëtarët.

2. Kjo Konventë mbetet në çdo rast në fuqi në formën dhe përmbajtjen e saj aktuale për ata anëtarë të cilët e kanë ratifikuar atë, por nuk kanë ratifikuar Konventën e rishikuar.

Neni 19

Versionet në gjuhën angleze dhe frënge të tekstit të kësaj Konvente janë njëjloj të barazvlefshme.

LIGJ
Nr.9774, datë 12.7.2007

PËR VLERËSIMIN DHE ADMINISTRIMIN E ZHURMËS NË MJEDIS

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit nga zhurmat, duke përcaktuar mënyrën e shmangies dhe masat për parandalimin, reduktimin dhe zhdukjen e efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshirë bezdinë nga zhurma.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ligji zbatohet për zhurmën, ndaj së cilës njerëzit ekspozohen në mjedisin ku ndodhen, në zona të banuara, në mjedise në institucione publike, në parqe publike dhe hapësira të tjera, të qeta, çlodhëse, në zona të qeta në natyrë, në institucionet për fëmijë, shëndetësore, arsimore, kulturore, të kultit dhe në mjedise të tjera të ngjashme me to.

2. Rrezikshmëri për shëndetin dhe mjedisin paraqet çdo zhurmë, që tejkalon nivelin kufi. Ministri, ministri që mbulon shëndetësinë dhe ministri që mbulon fushën përkatëse, me akt të përbashkët, miratojnë nivelin kufi të zhurmës për një mjedis të dhënë e për një fushë të caktuar të veprimtarisë ekonomike-shoqërore, i cili është i njëjtë me nivelin evropian të miratuar.

3. Ligji nuk zbatohet për zhurmën e lëshuar:

- a) nga veprimtaritë ushtarake në hapësira të përcaktuara për këtë qëllim;
- b) nga veprimtaritë, që ushtrohen për të zhdukur pasojat e një fatkeqësie natyrore, të një emergjence ose të një aksidenti;
- c) gjatë përballimit të një situatë, që vë në rrezik jetën dhe pronën e njerëzve, qeniet e gjalla dhe mjedisin në përgjithësi;
- ç) brenda shtëpisë, brenda mjeteve të transportit dhe brenda vendeve të punës, në rastet kur kjo nuk e kalon nivelin kufi, të miratuar për mjedisin e jashtëm. Për administrimin e zhurmës në vendet e punës zbatohen rregullat, kërkesat dhe masat e miratuara me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon shëndetësinë dhe të ministrit që mbulon punën.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Zhurmë mjedisore” është çdo tingull, i padëshiruar apo i dëmshëm, i lëshuar nga veprimtaritë njerëzore, përfshirë zhurmën e lëshuar nga mjetet e transportit, nga trafiku rrugor, hekurudhor, ajror dhe nga sheshet ku zhvillohen veprimtari industriale, të cilat janë objekt i këtij ligji.
2. “Efekte të dëmshme” janë efektet negative në shëndetin e njeriut dhe në mjedis.
3. “Bezdi nga zhurma” është shkalla e shqetësimit të komunitetit nga zhurma, e përcaktuar me mënyrën e vrojtimit në terren.

4. “Burim zhurme” është çdo makinë, instalim, mjet pune, mjet transporti, proces teknologjik, aparat elektroakustik, që lëshon zhurmë, njësitë e objekteve të lëvizshme ose të palëvizshme dhe veprimtaritë sportive dhe argëtuese.

5. “Nivel baze” ose “fon” është niveli i zhurmës mjedisore, kur burimi i zhurmës që matet nuk punon.

6. “Indikator i zhurmës” është madhësia fizike, e përdorur për të përshkruar zhurmën mjedisore, që ka lidhje me një efekt të dëmshëm.

7. “Vlerësim” është mënyra e përdorur, për të llogaritur, parashikuar, vlerësuar apo matur vlerën e indikatorit të zhurmës ose efektet e dëmshme që lidhen me të.

8. “Marrëdhënie dozë-efekt” është marrëdhënia ndërmjet nivelit të zhurmës dhe një efekti të dëmshëm.

9. “Zonë e banuar” është pjesa e një territori, me numër dhe dendësi popullesie, që e përcakton atë si një zonë urbane.

10. “Zonë e qetë në një zonë të banuar” është një zonë, e përcaktuar dhe e kufizuar nga organet e pushtetit vendor, e cila nuk ekspozohet ndaj një zhurme me vlerë më të lartë se një vlerë kufi.

11. “Zonë e qetë në një vend të hapur në natyrë” është një zonë, e përcaktuar dhe e kufizuar nga ministria, në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor, që nuk ekspozohet nga zhurma prej trafikut, industrisë ose veprimtarive të tjera.

12. “Hartëzim i zhurmës” është paraqitja me indikatorë e të dhënave për zhurmën, për një gjendje ekzistuese ose të parashikuar, që tregon kapërcimin e nivelit kufi, numrin e njerëzve të ndikuar në një zonë të caktuar ose numrin e banesave të ekspozuara ndaj disa vlerave të indikatorit të zhurmës në atë zonë.

13. “Hartë strategjike e zhurmës” është një hartë, që krijohet për vlerësimin global të ekspozimit ndaj zhurmës në një zonë të dhënë, nga burime të ndryshme zhurme ose për parashikimet e përgjithshme për një zonë të tillë.

14. “Nivel kufi” është një vlerë e indikatorit të zhurmës, kapërcimi i së cilës e detyron organin përgjegjës të shqyrtojë situatën dhe të kërkojë marrjen e masave zbutëse. Niveli kufi është i ndryshëm për:

- a) burime të ndryshme të zhurmës (zhurma të trafikut rrugor, hekurudhor, ajror, industrial);
- b) mjedise të ndryshme;
- c) popullata të ndryshme, me ndjeshmëri të ndryshme ndaj zhurmës;
- ç) situata të ndryshme, ekzistuese apo të reja, ku ndryshimi ka të bëjë me burimin e zhurmës ose me destinacionin e mjedisit rrethues.

15. “Plan veprimi” është dokumenti i hartuar, për të menaxhuar problemet dhe pasojat e zhurmës, përfshirë pakësimin e saj deri në nivelin kufi.

16. “Planifikim akustik” është kontrollimi i zhurmës, në të ardhmen, përmes masave të planifikuara si: planifikimi i përdorimit të tokës, sistemet inxhinierike për trafikun, planifikimi i trafikut, zbutja e zhurmës, përmes izolimit akustik dhe kontrolli i zhurmës që në burim;

17. “Publik” janë një ose më shumë persona fizikë ose juridikë, shoqatat, organizatat ose grupimet e tyre.

18. “Ministri” është ministri që mbulon mjedisin.

19. “Ministria” është ministria që mbulon mjedisin.

Neni 4

Detyrimi për zbatim

Mbrojtja nga zhurma sigurohet dhe zbatohet nga organet shtetërore, qendrore dhe vendore, sipas detyrave të përcaktuara nga ky ligj, nga persona fizikë e juridikë, veprimtaritë e të cilëve lëshojnë zhurmë, si dhe nga vetë qytetarët.

KREU II ORGANET PËRGJEGJËSE

Neni 5 **Organet qendrore**

1. Ministria është organi qendror përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit nga zhurma, nëpërmjet përcaktimit të niveleve kufi dhe zbatimit të masave mbrojtëse.
2. Ministria që mbulon shëndetësinë është organi qendror përgjegjës për mbrojtjen e shëndetit nga ndikimet negative të zhurmës.
3. Ministrinë e linjës, në fushat dhe sektorët që mbulojnë, marrin masa për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

Neni 6 **Këshilli Teknik për Zhurmat (KTZH)**

1. Pranë ministrit ngrihet Këshilli Teknik për Zhurmat (KTZH), si organizëm ndërinstitucional këshillimor për çështjet e zhurmës.
2. Përbërja dhe organizimi i KTZH-së miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

Neni 7 **Krijimi i njësisë për çështjet e zhurmës**

Në Institutin e Shëndetit Publik krijohet sektori i zhurmave, si njësi bazë e referencës për matjen, monitorimin dhe vlerësimin e saj.

Neni 8 **Organet e qeverisjes vendore**

Organet e qeverisjes vendore, brenda juridiksionit të tyre:

1. Drejtojnë hartimin dhe zbatimin e planeve vendore të veprimit për zhurmën, të cilat miratohen nga këshillat e bashkive/komunave.
2. Drejtojnë procesin e hartëzimit të zhurmës.
3. Shpallin zona të qeta, në një mjedis të banuar apo në një mjedis të hapur, si dhe vendosin kufizime të tjera për zhurmën, në përputhje me planin vendor të veprimit.
4. Kërkojnë nga personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari apo përdorin impiante dhe instalime që lëshojnë zhurmë, marrjen e masave parandaluese për respektimin e vlerës kufi të zhurmës.
5. U kërkojnë organeve të kontrollit të ushtrojnë kontroll, të bëjnë matje dhe të pezullojnë apo të mbyllin veprimtari, që nuk respektojnë dispozitat e këtij ligji.

KREU III MBROJTJA NGA ZHURMA

Neni 9 **Masat mbrojtëse**

1. Masat e mbrojtjes nga zhurma përbëjnë tërësinë e ndërhyrjeve dhe të veprimeve, që merren ndaj burimit të zhurmës, si dhe në vendin e ndikimit të saj negativ, duke e sjellë atë në nivelin kufi.
2. Masat e mbrojtjes nga zhurma përfshijnë:
 - a) përzgjedhjen dhe përdorimin e makinerive, të pajisjeve prodhuese e teknologjive dhe mjeteve

lëvizëse ose jolëvizëse, që lëshojnë zhurmë të niveleve të ulëta;

b) përzgjedhjen e vendit, që instalimi dhe funksionimi i mjeteve e pajisjeve që lëshojnë zhurmë, të garantojnë nivelin kufi në të gjitha mjediset, të cilat ndikohen prej saj;

c) masat parandaluese e zbutëse të zhurmës në pikën e lëshimit, përgjatë rrugëve të përhapjes dhe në mjediset që ndikohen prej saj.

3. Masat konkrete ndërmerren në bazë të matjes, llogaritjeve dhe monitorimeve të nivelit të zhurmës.

Neni 10

Oraret

Llojet e masave mbrojtëse nga zhurma zbatohen në lidhje të ngushtë me oraret kur lëshohet zhurma. Për këtë qëllim, 24 orët ndahen në këto orare:

1. Dita zgjat 13 orë, prej orës 06⁰⁰ deri në orën 19⁰⁰;

2. Mbrëmja zgjat 4 orë, prej orës 19⁰⁰ deri në orën 23⁰⁰;

3. Nata zgjat 7 orë, prej orës 23⁰⁰ deri në orën 06⁰⁰.

Neni 11

Kushtet për lëshuesit e zhurmës

1. Makineritë, mjetet e transportit, pajisjet e teknologjitë, para se të dalin në treg apo të vihen në përdorim, pajisen me dokumentacionin shoqërues, që tregon të dhënat për fuqinë e zhurmës që lëshojnë.

2. Personat fizikë dhe juridikë, që zotërojnë e përdorin burimet e zhurmës, plotësojnë kushtet teknike, që garantojnë respektimin e niveleve të zhurmës, të përcaktuara në dokumentacionin shoqërues.

3. Për burimet ekzistuese të zhurmës, brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, personat fizikë ose juridikë bëjnë ndërhyrjet e nevojshme për zbatimin e ligjit dhe të akteve përkatëse nënligjore.

Neni 12

Leja e mjedisit

1. Për personat fizikë dhe juridikë, veprimtaritë e të cilëve lëshojnë zhurmë në mjedis, në lejen e mjedisit përcaktohen edhe kushtet që duhet të respektojnë në zbatim të këtij ligji dhe të akteve përkatëse nënligjore.

2. Brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, kërkesës së pikës 1 të këtij neni i nënshtrohen edhe personat fizikë dhe juridikë, të pajisur me parë me leje mjedisore. Rregullat dhe procedurat për zbatimin e kësaj kërkesë miratohen me udhëzim të ministrit.

Neni 13

Planifikimi i rregullimit të territorit

1. Organet e qeverisjes qendrore apo vendore, personat fizikë e juridikë, që hartojnë apo miratojnë planet e rregullimit të territorit, zbatojnë kërkesat për reduktimin e zhurmës në mjedis.

2. Ministri, në bashkëpunim me ministrin që mbulon rregullimin e territorit, miraton udhëzimin për kërkesat dhe rregullat për reduktimin e zhurmave në mjedis që në procesin e hartimit të planeve të rregullimit të territorit.

Neni 14

Projektimi i ndërtesave

1. Çdo ndërtim dhe rikonstruksion ndërtesash, për banim apo për veprimtari të tjera ekonomike e shoqërore, projektohet dhe realizohet në mënyrë që zhurma në brendësi apo në afërsi të saj, të jetë brenda nivelit kufi. Ndryshimi i destinacionit të përdorimit të ndërtesës shoqërohet me masa mbrojtëse nga zhurma, për respektimin e vlerës kufi.

2. Ministri, në bashkëpunim me ministrin që mbulon punët publike, miraton udhëzimin për rregullat teknike dhe masat e mbrojtjes nga zhurma që në fazën e projektimit dhe gjatë ndërtimit të

ndërtesave.

Neni 15
Shfrytëzimi i ndërtesave

1. Organi i qeverisjes vendore, që jep lejen e shfrytëzimit të objektit, me përjashtim të banesave vetjake, verifikon edhe zbatimin e kërkesave të pikës 1 të nenit 14 të këtij ligji.
2. Ministri, në bashkëpunim me ministrin që mbulon punët publike, miraton udhëzimin për kërkesat dhe rregullat e verifikimit akustik të ndërtesave, para se ato të vihen në përdorim.

Neni 16
Zhurma nga mjetet e transportit

1. Të gjitha mjetet e transportit, përpara se të dalin në treg apo të futen në shërbim, i nënshtrohen kontrollit teknik, që verifikon edhe respektimin e niveleve kufi të zhurmës.
2. Personat fizikë e juridikë, që kanë në përdorim mjete transporti, plotësojnë kërkesat për nivelet kufi të zhurmës së lëshuar nga mjeti brenda 3 vjetëve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.
3. Ministri, në bashkëpunim me ministrin që mbulon transportin, miraton udhëzimin për kontrollin akustik të mjeteve.

Neni 17
Kërkesa për veprimtari të tjera

Për zhvillimin e veprimtarive argëtuese, të veprimtarive me grumbullime, manifestime, me kohë të kufizuar, në mjedise të jashtme apo të mbyllura, të cilat mund të bëhen burim shqetësimi për banorët, kërkohet miratimi nga njësi e qeverisjes vendore, në territorin e së cilës do të zhvillohen.

Neni 18
Veprime të ndaluara

Në territorin e Republikës së Shqipërisë janë të ndaluara:

1. Ushtrimi pa leje mjedisore i veprimtarive, që kapërcejnë nivelin kufi të zhurmave, duke prishur qetësinë dhe pushimin e njerëzve në mjedise të jashtme apo të brendshme.
2. Prodhimi, tregtimi dhe përdorimi i pajisjeve dhe makinerive pa dokumentacionin, që tregon nivelin e zhurmës që lëshojnë.
3. Rënia e borive dhe krijimi i zhurmave të tjera në mjedise të qeta, të shpallura të tilla me akt nënligjor nga organet e qeverisjes qendrore apo vendore.
4. Instalimi dhe funksionimi, në katet përdhese të ndërtesave të banimit, i veprimtarive të punimit të drurit, të metaleve, riparimit të pajisjeve e makinerive, i lokaleve të zhurmshme, i altoparlanteve e veprimtarive të tjera, të ngjashme me to, që lëshojnë zhurmë mbi nivelin kufi për mjediset e banimit.

KREU IV
VLERËSIMI I ZHURMËS

Neni 19
Vlerësimi

Treguesit, mënyrat e vlerësimit, rregullat dhe kërkesat teknike e metodike për vlerësimin e nivelit të zhurmës, si dhe për verifikimin e ndërhyrjeve të bëra për zgjidhjen dhe përmirësimin e gjendjes, miratohen nga ministri.

Neni 20

Planet e veprimit

1. Ministria, në bashkëpunim me ministrinë e linjës, harton planin kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave brenda 5 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Ministri miraton udhëzimin për kërkesat minimale për hartimin e planeve të veprimit.
3. Plani kombëtar i veprimit për menaxhimin e zhurmave miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.
4. Organet e qeverisjes vendore, një vit pas miratimit të planit kombëtar të veprimit, hartojnë planet vendore të veprimit, të cilat miratohen nga këshilli i bashkisë/komunës.

Neni 21

Hartëzimi

1. Hartëzimi i zhurmës në nivel kombëtar dhe vendor dhe hartat strategjike të zhurmës realizohen sipas udhëzimeve metodike dhe programit të miratuar nga ministri.
2. Organet e qeverisjes vendore realizojnë hartëzimin e zhurmës, në përputhje me planet e tyre të veprimit, sipas udhëzimeve të ministrit.

KREU V

EKSPERTIMI I ZHURMËS

Neni 22

Certifikimi dhe testimi

1. Ministria, në zbatim të kërkesave teknike e metodike, sipas këtij ligji dhe akteve të dala në zbatim të tij, certifikon ekspertë të zhurmës në mjedis. Kriteret, procedurat dhe rregullat për certifikimin, pezullimin dhe heqjen e certifikatës së ekspertit të zhurmës në mjedis miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.
2. Ministria mban regjistrin e ekspertëve të certifikuar të zhurmës në mjedis. Të dhënat e regjistrit janë të hapura për publikun.

Neni 23

Detyrat e ekspertit

1. Eksperti i certifikuar bën matje e vlerësime të zhurmës dhe të efekteve të saj, përgatit ekspertiza dhe projekte të mbrojtjes nga zhurmat dhe mbikëqyr zbatimin e tyre.
2. Eksperti i certifikuar është përgjegjës për punën që kryen e për rekomandimet që jep, si përpara porositesit, edhe përpara organit që e ka certifikuar.

KREU VI

MONITORIMI DHE KONTROLLI

Neni 24

Monitorimi

1. Monitorimi i zhurmës në burimin që e krijon dhe në mjedis, si dhe monitorimi i efekteve negative mbi shëndetin dhe mjedisin është i detyrueshëm.
2. Monitorimi i zhurmës në mjedis realizohet si pjesë e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit dhe financohet nga ministria.
3. Vetëmonitorimi i zhurmës në mjedis realizohet nga ekspertë të certifikuar dhe përballohet nga personat fizikë e juridikë, të cilëve u përkasin veprimtaritë, instalimet dhe burimet e zhurmës që monitorohen.
4. Kontrolli për cilësinë e monitorimit, të matjeve, të zbatimit të metodikave, të pajisjeve të përdorura dhe vërtetësisë së rezultateve, të dala nga monitorimi, realizohet nga Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve.

Neni 25

Matjet

1. Matjet për nivelin e zhurmës kryhen nga ekspertët e certifikuar.
2. Matjet kryhen në kuadër të kontrolleve dhe në funksion të zgjidhjes së ankesave të organeve shtetërore, të publikut e të personave juridikë e fizikë drejtuar ministrit përgjegjës, ministrit që mbulon shëndetësinë, organit të qeverisjes vendore, në territorin e të cilit ndodhet burimi i zhurmës, apo gjykatës.
3. Nëse zhurma, sipas rezultateve të matjeve, kalon nivelin kufi, eksperti i certifikuar sugjeron masat e nevojshme, në përputhje me dispozitat e këtij ligji e të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij. Organi, që ka vendosur kontrollin apo që shqyrton ankesën, urdhëron marrjen e masave nga personi fizik apo juridik, të cilit i përket burimi i zhurmës.

Neni 26

Ruajtja dhe publikimi i të dhënave

1. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve grumbullon, sistemon, përpunon dhe ruan të dhënat e monitorimit të zhurmave, të ndara në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor, si dhe në bazë të sektorëve e të fushave të veprimtarisë.
2. Të dhënat për zhurmat ruhen në arkivin e Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve, në përputhje me kërkesat e nenit 43 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat".
3. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, në bazë të të dhënave, të rezultateve të monitorimit dhe të matjeve të zhurmës, harton raporte e informacione dhe bën publikime në media ose mjete të tjera të përshtatshme, në një formë të kuptueshme nga publiku.

Neni 27

Regjistrat e zhurmës

1. Ministri miraton formatin e regjistrit të zhurmës, si dokumenti bazë, ku pasqyrohen të dhënat e treguesit e saj, që rezultojnë nga monitorimi dhe matjet.
2. Personat fizikë e juridikë, të pajisur me leje mjedisore, hedhin në regjistrat e shkarkimeve edhe të dhënat për zhurmën, që lëshojnë veprimtaritë e tyre dhe, në bazë të tyre, raportojnë në agjencinë rajonale përkatëse të mjedisit, sipas formularit të miratuar nga ministri.
3. Regjistri përmban të dhëna, që identifikojnë burimin dhe nivelin e zhurmës, si dhe masat që janë marrë për mbajtjen e zhurmës në nivelin kufi.

Neni 28

Kontrolli

Kontrolli për zbatimin e dispozitave të këtij ligji e të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij, ushtrohet mbi:

- a) burimet e zhurmës, të veprimtarive të pajisura me leje mjedisore;
- b) çdo burim zhurme në mjediset urbane të qyteteve dhe fshatrave, kur ka ankesë me shkrim;
- c) objektet në ndërtim, rikonstruksion dhe para vënies në shfrytëzim;
- ç) mjetet e transportit.

Neni 29

Organet e kontrollit

1. Kontrolli i zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe i akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij, kryhet nga Inspektorati i Mjedisit, Inspektorati Sanitar Shtetëror, Inspektorati Shtetëror i Punës, struktura përgjegjëse për kontrollin e mjedisit e bashkisë/komunës dhe Inspektorati i Kontrollit të Automjeteve.
2. Organet e përmendura në pikën 1 të këtij neni ushtrojnë kontroll për zhurmën, në përputhje

me dispozitat e akteve ligjore, që kanë miratuar krijimin dhe funksionimin e tyre.

3. Personat fizikë e juridikë, gjatë kontrollit të veprimtarisë së tyre, krijojnë të gjitha kushtet për zhvillimin normal të kontrollit.

Neni 30
Vendimi i kontrollit

1. Në mbështetje të kontrollit të ushtruar, grupi i kontrollit evidenton situatën dhe problemet, cakton masat dhe detyrat për rregullimin e gjendjes, ndëshkon me gjobë kundërvajtjet administrative dhe, sipas rastit, vendos mbylljen, ndalimin apo ndërprerjen e plotë ose të pjesshme të veprimtarisë.

2. Rezultatet dhe vendimi i kontrollit i njoftohen subjektit të kontrolluar dhe organit të qeverisjes vendore, në territorin e të cilit ndodhet veprimtaria e kontrolluar. Një përmbledhje e vendimit të kontrollit vihet në dispozicion të publikut për 1 muaj, duke u depozituar në organin e qeverisjes vendore përkatëse.

Neni 31
Masat gjatë kontrollit

1. Gjatë kryerjes së kontrollit, grupi i kontrollit urdhëron:

a) kryerjen e matjeve të zhurmsë së veprimtarive të personave fizikë apo juridikë, që përdorin burimin e zhurmsë në një mjedis ku punojnë ose qëndrojnë njerëz;

b) zbatimin e masave të kërkuara për mbrojtjen nga zhurma;

c) ndalimin e përdorimit të ndërtesave, të reja apo të rikonstruara, derisa në to të zbatohen masat për mbrojtjen nga zhurma;

ç) ndalimin e përdorimit të burimit të zhurmsë, derisa të jenë zbatuar tërësisht masat për mbrojtjen nga zhurma;

d) ndalimin e veprimtarive të zhurmshme, që prishin pushimin dhe qetësinë e natës, nëse këto nuk mund të arrihen duke zbatuar masat e marra;

dh) ndërprerjen e punës dhe të veprimtarive që lëshojnë zhurmë, nëse kanë filluar pa miratimin e organit përkatës se janë zbatuar masat e mbrojtjes nga zhurma.

2. Në rast kundërshtimi për zbatimin e masave të mësipërme, bashkëpunohet me Policinë e Shtetit dhe me policinë e bashkisë/komunës.

KREU VII
SANKSIONET

Neni 32
Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen nga organet e kontrollit, të parashikuara në nenin 29 të këtij ligji, me gjobë, si më poshtë:

a) ushtrimi pa leje mjedisore, me specifikim për zhurmat, i veprimtarive që lëshojnë zhurmë mbi nivelin kufi të lejuar për mjedisin përkatës, nga 30 000 lekë deri në 50 000 lekë;

b) prodhimi, tregtimi dhe përdorimi i pajisjeve dhe i makinerive pa dokumentacionin që tregon nivelin e zhurmsë që lëshojnë, nga 10 000 lekë deri në 30 000 lekë;

c) lëshimi i zhurmsë në mjedise të qeta, të shpallura të tilla me akt nënligjor të organeve të qeverisjes qendrore apo vendore, nga 1 000 lekë deri në 5 000 lekë;

ç) refuzimi e moslejimi i grupit të kontrollit për kontroll apo i ekspertit të certifikuar, të autorizuar, për të kryer matjet akustike, nga 10 000 lekë deri në 20 000 lekë;

d) fillimi i punës ose i veprimtarisë, pa zbatuar masat e mbrojtjes nga zhurma, që kërkohen në lejen mjedisore, nga 10 000 lekë deri në 30 000 lekë;

dh) moszbatimi i masave të mbrojtjes nga zhurma, të kërkuara me shkrim nga kontrolli, nga 20 000 lekë deri në 30 000 lekë;

e) instalimi dhe vënia në punë e veprimtarive, makinerive dhe impianteve në mjedise të brendshme apo të jashtme, pa zbatuar masa parandaluese e mbrojtëse, zhurma e të cilave kapërcen nivelin kufi, nga 5 000 lekë deri në 10 000 lekë;

ë) shfrytëzimi dhe vënia në përdorim e objekteve industriale, që nuk janë pajisur me masat mbrojtëse nga zhurma, nga 30 000 lekë deri në 50 000 lekë.

2. Krahas dënimit me gjobë, në varësi të dëmit që shkakton zhurma, vendoset edhe mbyllja e përkohshme ose përhershme e burimit të zhurmës.

Neni 33

Ankimi

1. Kundër vendimit të ndëshkimit, brenda 10 ditëve nga njoftimi i tij, mund të bëhet ankim te ministri, i cili ka në varësi inspektoratin, apo te kryetari i bashkisë/komunës, i cili ka në varësi strukturën përgjegjëse për kontrollin e mjedisit që ka marrë vendim. Ministri apo kryetari i bashkisë/komunës përgjigjet brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

2. Kundër vendimit të ministrit apo të kryetarit të bashkisë/komunës ose kur këta nuk përgjigjen brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, mund të bëhet ankim brenda 30 ditëve në gjykatë.

Neni 34

Arkëtimi

1. Gjobat e vendosura për kundërvajtjet administrative, sipas këtij ligji, paguhen në organin që ka vendosur gjobën, sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në aktet që rregullojnë veprimtarinë e këtyre inspektorateve.

2. Të ardhurat nga gjobat i kalojnë Buxhetit të Shtetit kur ato janë vendosur nga inspektoratet e përmendura në nenin 29 të këtij ligji dhe bashkisë/komunës kur ato janë vendosur nga struktura përgjegjëse për kontrollin e mjedisit në bashki/komunë.

Neni 35

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 6 pika 2, 7 pika 1 e 22 pika 1 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri që, në bashkëpunim me ministrat përkatës, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 2 pikat 2 dhe 3 shkronja "ç", 12 pika 2, 13 pika 2, 14 pika 2, 15 pika 2, 16 pika 3, 19, 20 pika 2, 21 pika 1 e 27 pika 1 të këtij ligji.

Neni 36

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5410, datë 19.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ
Nr.9775, datë 12.7.2007

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7926, DATË 20.4.1995 “PËR TRANSFORMIMIN E
NDËRMARRJEVE SHTETËRORE NË SHOQËRI TREGTARE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 7 të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, pas paragrafit të fundit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Në rastet kur procedurat e privatizimit pengohen pa shkaqe të përligjura nga strukturat përgjegjëse të njësive të qeverisjes vendore apo të institucioneve qendrore, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës i propozon organit ekzekutiv vendimmarrës të njësive të qeverisjes vendore apo titullarit të institucionit qendror marrjen e masave disiplinore për personat përgjegjës.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.5411, datë 19.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ
Nr.9776, datë 12.7.2007

**PËR DISA SHITESA NË LIGJIN NR.9072, DATË 22.5.2003 “PËR SEKTORIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 3, pas pikës 21 shtohet pika 21/1 me këtë përmbajtje:

“21/1 “Linjat tregtare të interkonjeksionit” janë linjat e reja elektrike të interkonjeksionit, me rrymë të vazhduar, ndërmjet dy sistemeve kombëtare elektrike, si dhe të nënstacioneve të invertimit, të ndërtuara me nismën dhe kapitalin e palëve të treta.

Në raste të veçanta, linja tregtare të interkonjeksionit janë dhe linjat e reja të interkonjeksionit, me rrymë alternative, kur kostoja dhe risku i investimit janë shumë të lartë në krahasim me koston dhe riskun, që investitori merr përsipër në ndërtimin e linjave të interkonjeksionit, me rrymë alternative, ndërmjet dy sistemeve fqinje.”.

Neni 2

Pas nenit 31 shtohet neni 31/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 31/1

1. Ndërtimi i linjave tregtare të interkonjeksionit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) ndërtimi i linjës nuk cenon qëndrueshmërinë dhe sigurinë e operimit të sistemit elektroenergjetik kombëtar;

b) linja tregtare e interkonjeksionit është në pronësi të një subjekti, person ligjërishit i ndarë nga Operatori i Sistemit të Transmetimit;

c) të gjitha shpenzimet për ndërtimin dhe lidhjen e linjës me sistemin e transmetimit përballohen nga vetë investitori;

ç) asnjë pjesë e kostove, kapitale dhe operacionale, të linjës tregtare të interkonjeksionit nuk përfshihet në koston e Operatorit të Sistemit të Transmetimit;

d) investitori bie dakord që 20 për qind e kapacitetit të linjës tregtare të interkonjeksionit të shfrytëzohet për përdorim publik nga Operatori i Sistemit të Transmetimit.

2. Këshilli i Ministrave, përpara miratimit të linjave tregtare të interkonjeksionit, merr mendimin e Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike dhe të Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

3. Afati i shfrytëzimit të linjës tregtare të interkonjeksionit nga investitori është 20 vjet. Pas mbarimit të këtij afati, asetet kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

4. Operimi i linjave tregtare të interkonjeksionit bëhet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, sipas dispozitave të kodit të funksionimit të rrjetit dhe rregullave të tregut.

5. Mirëmbajtja e linjave tregtare të interkonjeksionit është përgjegjësi e investitorit privat gjatë gjithë kohës që ai ka në pronësi këtë linjë.

6. Kapaciteti i linjës së interkonjeksionit, që shfrytëzohet për interes publik, sipas shkronjës “d” të pikës 1 të këtij neni, shpërndahet në përputhje me rregullat e miratuara nga ERE.”.

Neni 3

Në nenin 41, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) operimi i linjave tregtare të interkonjeksionit.”.

Neni 4

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë kriteret dhe procedurat e zbatimit dhe të miratimit të ndërtimit të një linje tregtare interkonjeksioni.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5412, datë 19.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**
 - i. **PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... 1300**
 - ii. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT..... 500**
 - iii. **PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË..... 1000**
 - iv. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR..... 800**
 - v. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET..... 500**
 - vi. **PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)..... 1000**
 - vii. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE..... 500**

TREGUES LEGJISLACIONI

- 1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
- 2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
- 3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
- 4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**

Hyri në shtyp më 24.7.2007
 Doli nga shtypi më 26.7.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
 Tiranë, 2007

Çmimi 28 lekë